



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

Legjislatura III  
Komisioni për Integritim Evropian  
Mbledhja nr. 40  
Prishtinë, më 08. 09. 2009, ora 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-203

**PROCESVERBAL**  
**I mbledhjes së Komisionit për Integritim Evropian**

Në mbledhje morën pjesë: Zylfije Hundozi, Bujar Bukoshi, Džezair Murati, Hydajet Hyseni, Edita Tahiri, Fatmir Rexhepi, Nait Hasani, Njomza Emini, Naser Rugova dhe Mursel Halili.

Mungoi: Sabri Hamiti.

Nga stafi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha dhe Adelina Demolli.

Mbledhjen e kryesoi Zylfije Hundozi - kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 26. 06. 2009, 02. 07. 2009 dhe 06. 07. 2009;**
- 3. Takim me zëvendëskryeministrin, Hajredin Kuçi;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për gazin natyror, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-33 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit për standardizimin, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-145 për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e Rinisë, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

**8. Shqyrtimi i Projektligjit për masat antidamping, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

**9. Të ndryshme.**

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

### **3. Takim me zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi;**

**Kryesuesja** - Tha se e kemi ftuar zëvendëskryeministrin sot, sepse Qeveria e ka hartuar Planin e Veprimit për vitin 2009 dhe dëshirojmë të dimë se cilat janë ndryshimet ndërmjet këtij dhe planit të vjetër. Po ashtu desh të dinte sa janë përmbushur veprimet nga Plani i Veprimit të vjetër.

**Hajredin Kuçi** - Tha se Plani i Veprimit të Partneritetit Evropian (PVPE), është miratuar nga Qeveria më 13 gusht 2009. PVPE-ja ka në vete gjithsej 1598 veprime, që do të zbatohen në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme. Përparësi në krahasim me vitin e kaluar, lidhur me procesin e rishikimit të PVPE-së, është përfshirja e të gjitha ministrive dhe identifikimi i veprimeve prej tyre. Agjencia për Koordinim të Zhvillimit dhe e Integritimit Evropian vetëm e ka lehtësuar procesin e identifikimit të veprimeve të reja, mirëpo puna kryesore është bërë nga ministritë. Dallimi ndërmjet këtij dhe planit të mëhershëm është se vetëm janë hequr veprimet, të cilat nuk janë të matshme ose nuk janë reale për t'u zbatuar. Sa i përket Qeverisë i ka funksionalizuar strukturat për integrim evropian, të përcaktuara në Planin për integrim evropian 2008-2010. Njoftoi se më 16 shtator do të jenë në Bruksel në takim me Pierre Mirell dhe me zyrtarë të tjerë të Drejtoratit të Përgjithshëm të Zgjerimit, ku do të bisedohet për Raportin e Progresit dhe për Studimin e Vizibilitetit. Shtoi, pasi PVPE-ja dhe plani që e përpiloni ju, lidhur me Raportin e Progresit, janë dy dokumente që e plotësojnë njëra-tjetrën. Ju ftoj ta keni parasysh dhe ta inkorporoni PVPE-në në raportin tuaj.

**Kryesuesja** - Lidhur me 1598 veprime tha se konsideronte se do të ishte më mirë sikur të kishte veprime më pak, por që do të ishin më cilësore. Këtë e them, sepse nga 110 sfidat, të cilat i kishim në Planin e Veprimit të Komisionit për Integritime, as 60% e tyre nuk janë realizuar nga Qeveria. Qëndrim i Komisionit për Integritime Evropiane është që Plan i Veprimit të shqyrtohet në seancë plenare dhe një gjë të tillë duhet ta bëjmë sa më parë. Sa është kostoja e zbatimit të këtij plani dhe kush do ta financojë zbatimin e këtyre veprimeve.

**Hajredin Kuçi** - Sa u përket 1598 veprimeve, çdo propozim për veprim ka ardhur nga ministritë përkatëse dhe veprimet janë për planin afatshkurtër dhe afatmesëm. Është i bindur se të gjitha ministritë janë përgjegjëse t'i kryejnë këto veprime dhe këtë do ta

bëjnë në mënyrën më adekuate. Sa i përket debatit për Planin e Veprimit, tha: Dëshirojmë vetëm ta marrim pëlqimin nga Komisioni juaj. Prej sot do të kërkojmë që ky plan të diskutohet në seancë.

**Dzezair Murati** – E falënderoi zëvendëskryeministrin që gjithmonë i përgjigjet ftesës së Komisionit. Theksoi se Komisioni për Integritet Evropian ka bashkëpunuar me institucionet, ka arritur rezultate dhe njëkohësisht për të gjitha çështjet ka pasur konsensus. Njoftoi për dy vizitat e Komisionit në Shqipëri dhe në Kroaci dhe për takimet me ministritë për integritet. Përvojat e tyre na kanë shërbyer si model, andaj kërkoj ndihmë për takime të mëtejme. Në vazhdim kërkoi nga zëvendëskryeministri ta njoftojë Komisionin për qëndrimin institucional për Protokollin me EULEX-in, sepse ka mendime të ndryshme.

**Hydajet Hyseni** – Sa i përket Planit të Veprimit më duhet ta analizoj, sepse sot e kam marrë këtë material. Mirë që është punuar në këtë drejtim, sepse përveç sfidave ka edhe suksese, të cilat nuk janë raportuar, por janë paraqitur si sfida ose jo të arritura. Mbështeti përpjekjet e të gjitha institucioneve dhe të Qeverisë që janë bërë për t'i përmbushur kërkesat e partnerëve evropianë. Për mua, tha, është e rëndësishme së veçantë çështja e Protokollit për bashkëpunim policor. Duke e mbështetur qëndrimin e institucioneve tona, mund ta konstatoj shqetësimin tim dhe të shoqërisë, se një qëndrim i drejtë, por pak a shumë i vonuar, që është pasojë e disa vonesave të mëhershme, është shkas për të shkuar në një skaj në tjetrin. Nëse i kemi neglizhuar disa angazhime, që kanë qenë tonat, dhe shfrytëzohen ndonjëherë edhe prej atyre që s'ia duan të mirën Kosovës, nuk duhet të lejojmë të na nxjerrin prej binarëve dhe të pozicionohemi në një mënyrë të tillë, që mund të jetë kundërproduktive. Zgjidhja është në diferencimin e asaj, që është interes dhe kompetencë e Kosovës, e cila nuk duhet të lejohet të tjetërsohet dhe të veçohet, duke i thënë jo asaj që duhet thënë prerazi jo, por duke i pranuar të gjitha ato që janë të nevojshme dhe të dobishme për Kosovën. Për më tepër, Kosova nuk ka asnjë arsye të ngurrojë që ta ballafaqojë realitetin, sepse është realitet që na nderon. Realiteti i ndërtuar është bazë e fortë mbi të cilën mund të ndërtohet zgjidhja, e cila nuk lejon të kthehemi prapa, por nuk lejon as të keqpërdoremi dhe të na hedhin prej një skaji në tjetrin.

**Fatmir Rexhepi** - Sot morëm njoftim se Qeveria e ka hartuar Projektplanin e veprimit. Do të kemi mundësi që në një seancë ta bëjmë krahasimin ndërmjet Planit të veprimit të Qeverisë, planit të mëparshëm të veprimit dhe Planit të Veprimit të Komisionit për Integritet Evropian. Theksoi se çështja e përmbushjes së sfidave nga ana e institucioneve përgjegjëse nuk do të jetë e lehtë, andaj duhet të punojmë më shumë. Hëpërhë shqetësim është partneriteti aktual ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe EULEX-it, i cili nuk na kanë dhënë shembull të mirë deri më tani se është në nivelin e duhur në qeverisjen dhe në progresin që i duhet vendit tonë. Shtoi se kjo mungesë e transparencës, nga të dyja anët, kompetencat të cilat janë të përcaktuara edhe me Kushtetutë, por edhe me Pakon e Ahtisarit, shmangia selektive nga ajo që po ndërmerret në disa hapa që kanë peshë të madhe politike, që pastaj po e prekin edhe

stabilitetin e brendshëm politik dhe nuk po mundësojnë funksionim e asaj të paraparë me shpalljen e Pavarësisë dhe me miratimin e Kushtetutës. Këto janë shqetësime kryesore të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Kërkoj që Kuvendi të mos anashkalohej për procese të rëndësishme që po ndodhin. Duhet të flasin në foltore dhe të jenë më transparentë, sepse kështu çështjet do të zgjidhen më mirë dhe do të merren përgjegjësi nga secili institucion.

**Naser Rugova** - Tha se pas një debati në seancë vjen një projekt i ri nga Qeveria. Meqë kanë mbetur vetëm edhe katër muaj deri në fund të vitit e konsideroj të vonuar. Sa u përket 1598 veprimeve të parapara me Planin e Veprimit konsideroj se është shumë mirë që janë identifikuar këto veprime, mirëpo janë të porealizueshme, sepse nga 110 sfidat, të cilat ishin në Planin e Veprimit të Komisionit për Integritet, mezi kemi arritur të marrim përgjigje të pjesshme për 55 sosh. Si Komision kemi kryer 80% të punës pa mbështetje të duhur nga Kryesia dhe nga kryetari i Kuvendit. Kërkoj të respektohen hierarkia dhe inputet të vijnë nga Qeveria, ku AKZHIE duhet koordinojë, sepse ka pasur mungesë të informatave cili institucion është përgjegjës për sfidën e caktuar. Kërkoj të shikohet kostoja buxhetore e zbatimit të këtij dokumenti. Bashkëpunimi rajonal e prek edhe çështjen e Protokollit, çështje që është diskutuar shumë. Shikoni dispozitat kalimtare të Kushtetutës dhe në një formë duhet të jeni të kujdesshëm, sepse nëse EULEX-i ka nënshkruar marrëveshje me Maqedoninë dhe me Shqipërinë, pritet që në fushën e sigurisë, të rendit dhe të ligjit, marrëveshje të tilla të bëhen edhe me vende të tjera. Kemi nënshkruar Pakon e Ahtisarit dhe e kemi shpallur Pavarësinë sipas asaj pakoje. Është dashur atëherë të mendoheshin dhe të thuheshin këto gjëra. Inkurajoj ta marrin më seriozisht këtë proces dhe në Planin e ri të Veprimit të mos hyhet me ambicie të tepruara.

**Edita Tahiri** - Sa i përket bashkëpunimit ndërmjet Komisionit për Integritet Evropian dhe Qeverisë, ka pasur vullnet të mirë, por ka pasur edhe shumë vështirësi dhe ngecje. Gjatë procesit të hartimit të Raportit të Planit të Veprimit, jemi ballafaquar me dy elemente: fuqinë e dobët të institucioneve tona, ku theksi duhet të bjerë në fuqinë zbatuese dhe në mungesën e njoftimeve të plota e profesionale. Kërkoj përkrahje nga Qeveria për punën e Komisionit për Integritet Evropian.

Sa i përket Protokollit, bashkëpunimi me BE-në dhe protokollin ndërlidhen drejtpërdrejt me integritet evropian. Mos na lini, ne zyrtarëve, të mësojmë nga mediat se çka përmbajnë dokumentet, sepse kemi nevojë të kemi informacione të sakta dhe të mbështetemi në çështje të dokumentuara. Sugjeroj dy parime, sa i përket çështjes së nënshkrimit të Protokollit: mbrojtjen e sovranitetit të Kosovës, mbrojtjen e përgjegjësisë së institucioneve të Kosovës, ashtu siç thuhet në Kushtetutën e Kosovës. Parimi tjetër është se nuk duhet ta cenojmë bashkëpunimin me këto organizata të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e Protokollit është e kontestueshme, sepse drejtpërdrejt cenohen sovraniteti dhe integriteti i Kosovës. EULEX-i na ka njoftuar për disa përgjegjësi ekzekutive, mirëpo deklaratat e qeveritarëve tanë thoshin se EULEX-i dhe ICO-ja nuk kanë kompetenca ekzekutive. Kjo duhet të sqarohet, sepse krijon mundësi të jemi më korrektë kundrejt këtyre çështjeve. Komisioni po punon me seriozitet, por

nuk ka përkrahje as prej jush, as nga Kuvendi. Bëri me dije se Kryesia e Kuvendit nuk lejoi të shkohej për vizitë në Spanjë.

**Njomza Emini** - U pajtua me diskutimin e deputetes Edita. Kërkoj të dinte se deri ku ka shkuar procesi i përkthimit të legjislacionit të BE-së. Kërkoj që Plani i Veprimit të diskutohet në seancë plenare.

**Hajredin Kuçi** - Sa i përket kostos financiare, kemi formuar grup pune për shqyrtimin e implikimeve financiare dhe i kemi marrë parasysh Planin e Qeverisë për vitin 2008 - 2010, kornizën afatmesme të shpenzimeve, buxhetin e Kosovës dhe parashikimet buxhetore. Tha se ka nevojë për një bashkërendim më të mirë ndërmjet të gjitha institucioneve të Kosovës, por edhe me ato që janë jashtë kompetencës së Kuvendit dhe të Qeverisë, veçanërisht me sistemin e drejtësisë, sepse shumë sfida dalin nga sundimi i rendit dhe i ligjit. Sa i përket bashkëpunimit rajonal, kemi bashkëpunim shumë të mirë, por është kusht që Kosova të trajtohet si shtet i pavarur dhe sovran. Pohoi se ngatërrohen përgjegjësitë, por me këtë plan saktësohen përgjegjësitë e secilit institucion. Fuqia e zbatimit, varet nga mungesa e kapaciteteve të këtyre institucioneve. Shtoi se kemi dërguar për t'u specializuar në fushën e integriteteve evropiane 75 persona, të cilët do të punojnë 2 vjet për institucionet e Kosovës. Propozoi që Komisioni për Integritete ta zgjedhë një ekspert, të cilin financiarisht do ta mbështesë Qeveria, për ta ndihmuar Komisionin. Nëse Komisioni nuk gjen përkrahje nga Kryesia dhe nga kryetari i Kuvendit, nuk mund të ndërhyjmë në marrëdhëniet ndërmjet organeve të Kuvendit. Për Protokollin e bashkëpunimit policor kemi pasur informata se janë duke u bërë bisedime ndërmjet EULEX-it, Shqipërisë dhe Maqedonisë, por nuk kemi pasur ide se është duke u bërë një projekt edhe me Serbinë. Kemi reaguar për Protokollin, por nuk kemi telashe me EULEX-in, as me BE-në, por me Serbinë. EULEX-i ka fuqi vetëm për ta mbikëqyrur zbatimin e Pakos së Ahtisarit. Çdo marrëveshje, që bëhet jashtë institucioneve të Republikës së Kosovës, për Kosovën, për ne është e barabartë me zero. Jam i bindur se do të marrim vendim për t'i mbrojtur interesin kombëtar, aktet juridike që i ka Kosova, njëherësh për ta mbrojtur edhe partneritetin me Bashkimin Evropian.

**Nait Hasani** - Gjuhë zyrtare është shqipja, andaj kërkoj që të gjitha dokumentet që u dërgohen deputetëve, të jenë në gjuhën shqipe. Pyeti a ka ministri të punëve të jashtme dhe sa është funksionale?

**Hajredin Kuçi** – U përgatita që sot të diskutoja vetëm për Planin e Veprimit. Sa i përket ministrit të Punëve të Jashtme, shpresoj se atë do të keni mundësi ta keni në takim. Kushdo që bën punë të mirë për Kosovën, është i mirëpritur.

#### **4. Shqyrtimi i Projektligjit për gazin natyror, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së**

**Kryesuesja** – E ftoi deputetin Naser Rugova ta paraqiste Raportin për përputhshmërinë e projektligjit me legjislacionin e BE-së.

**Naser Rugova** - Tha se në mbështetje të Divizionit për Standardizim e kemi shqyrtuar këtë projektligj me amendamentet e Komisionit Funkcional. Konsideroj se mund të procedohet, sepse nuk i cenon parimet e *Acquis communautaire*. Kërkoj që të gjitha aktet nënligjore, që do të nxirren, të jenë në harmoni me *Acquis communautaire*.

**Hydajet Hyseni** - Kërkoj t'u shpërndahet materiali mbështetës në bazë të të cilit harmonizohet legjislacioni ynë me të BE-së.

*Kryesuesja konstatoi se Komisioni nxori këtë*

#### ***Përfundim***

**Projektligji për gazin natyror, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nuk i cenon parimet themelore të *Acquis communautaire* dhe politikat e BE-së.**

#### **5. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-33 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.**

**Kryesuesja** – E ftoi deputeten Njomza Emini ta paraqiste Raportin për përputhshmërinë e projektligjit me legjislacionin e BE-së.

**Njomza Emini** - Tha se në mbështetje të Divizionit për Standardizim e kemi shqyrtuar këtë projektligj me amendamentet e Komisionit Funkcional. Konsideroj se mund të procedohet, sepse kjo fushë nuk është e rregulluar me *Acquis communautaire*.

*Kryesuesja konstatoi se Komisioni nxori këtë*

#### ***Përfundim***

**Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-33 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nuk është rregulluar sipas *Acquis communautaire*.**

**6. Shqyrtimi i Projektligjit për standardizimin, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së**

**Kryesuesja** – E ftoi deputeten Edita Tahiri ta paraqiste Raportin për përputhshmërinë e projektligjit me legjislacionin e BE-së.

**Edita Tahiri** - Tha se në mbështetje të Divizionit për Standardizim e kemi shqyrtuar këtë projektligj me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL. Konsideroj se mund të procedohet, sepse nuk i cenon parimet e *Acquis communautaire*.

*Kryesuesja konstatoi se Komisioni nxori këtë*

***Përfundim***

**Projektligji për standardizimin, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, nuk i cenon parimet themelore të Acquis communautaire dhe politikat e BE-së.**

**7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-145 për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.**

**Njomza Emini** - Tha se në mbështetje të Divizionit për Standardizim e kemi shqyrtuar këtë projektligj me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL. Konsideroj se mund të procedohet, sepse nuk i cenon parimet e *Acquis communautaire*.

*Kryesuesja konstatoi se Komisioni nxori këtë*

***Përfundim***

**Projektligji nr. 03/L-145 për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, nuk i cenon parimet themelore të Acquis communautaire dhe politikat e BE-së.**

**8. Shqyrtimi i Projektligjit për masat antidamping, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së**

**Kryesuesja** – E ftoi deputeten Edita Tahiri ta paraqiste Raportin për përputhshmërinë e projektligjit me legjislacionin e BE-së.

**Edita Tahiri** - Tha se në mbështetje të Divizionit për Standardizim e kemi shqyrtuar këtë projektligj me amendamentet e Komisionit Funkcional. Konsideroj se mund të procedohet, sepse nuk i cenon parimet e *Acquis communautaire*.

**Kryesuesja** konstatoi se Komisioni nxori këtë

### ***Përfundim***

**Projektligji për masat antidamping, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nuk i cenon parimet themelore të Acquis communautaire dhe politikat e BE-së.**

## **9. Të ndryshme**

### **a) Ndarja e buxhetit për Komisionin e Integritimeve Evropiane**

Pas diskutimeve të deputetëve u nxor ky

### **Përfundim**

Të shqyrtohet mundësia e përdorimit të të hollave të parapara për Komisionin e Integritimeve Evropiane.

T'i bëhet një kërkesë Qeverisë së Republikës së Kosovës për ta sponsoruar vizitën e Komisionit të Integritimeve Evropiane në Suedi.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E hartoi:  
Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryesuesja e Komisionit

---

Zylfije Hundozi